

# LINGUISTIC CONSULTANCY OF PRISHTINA – AN IMPORTANT EVENT IN THE CULTURAL LIFE OF ALBANIANS IN FORMER YUGOSLAVIA

**Agim Vinca**

## **Abstract**

Prishtina's Language Consultancy (Prishtina, April 22-23, 1968) was a wide gathering of Albanian linguists and intellectuals from Kosovo, Macedonia and other Albanian territories in the former Yugoslavia, where they discussed the *Spelling rules* (project), drafted a year before (1967) in Tirana and released for public discussion. In this Consultancy, as it was called, organized by the Albanological Institute of Prishtina and the Department of Albanian Language and Literature of the Faculty of Philosophy, after a broad and general debate, it was decided that the Albanians in Yugoslavia would use the same language and spelling, in their public life, as the one used in the mother country, in the Republic of Albania.

The aim of this paper is to highlight the Prishtina Language Consultancy, which, as such can be said to have preceded the Congress of Orthography, which would be held four years later in Tirana (November 1972), in which a complete unification of the Albanian literary language was reached. Viewed from this aspect, it can be said that Prishtina's Consultancy is a major event for Albanian language and Albanian culture in general.

**Keywords:** nation, language, culture, variety, standard, spelling, unification, etc.

# KONSULTA GJUHËSORE E PRISHTINËS – NGJARJE E RËNDËSISHME NË JETËN KULTURORE TË SHQIPTARËVE NË ISH-JUGOSLLAVI

**Agim Vinca**

## **Abstrakt**

Konsulta Gjuhësore e Prishtinës (Prishtinë, 22-23 prill 1968), ishte një mbledhje e gjerë e gjuhëtarëve dhe intelektualëve shqiptarë të Kosovës, të Maqedonisë dhe të viseve të tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, në të cilën u diskutuan *Rregullat e drejtshkrimit* (projekt), të hartuara një vit më parë (1967) në Tiranë dhe të lëshuara në diskutim publik. Në këtë Konsultë, si u quajt, të organizuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe e Fakultetit Filozofik, pas një debati të gjërë e të gjithashëm, u mor vendimi që shqiptarët në Jugosllavi të përdornin në jetën publike të njëjtën gjuhë dhe të njëtin drejtshkrim, që ishin në përdorim në shtetin amë, në Republikën e Shqipërisë.

Qëllimi i këtij punimi është i përqëndruar në nxjerrjen në pah të Konsultës Gjuhësore e mbajtur në Prishtinë, e cila si e tillë, mund të thuhet se i parapriu Kongresit të Drejshkrimit, që do të mbahej katër vjet më vonë në Tiranë (nëntor 1972), në të cilin u bë njësimi i plotë i gjuhës letrare shqipe. Shikuar nga ky aspekt mund të thuhet se Konsulta e Prishtinës është një ngjarje me rëndësi të madhe për gjuhën shqipe dhe kulturën shqiptare në përgjithësi.

**Fjalët kyçe:** komb, gjuhë, kulturë, variant, standard, drejtshkrim, njësim etj.

Konsulta Gjuhësore e Prishtinës, që zhvilloi punimet më 22 e 23 prill 1968, është një ngjarje me rëndësi kapitale për gjuhën shqipe dhe kulturën shiptare. As vetë ata që e kishin thirrur këtë mbledhje të gjerë të intelektualëve shqiptarë, nuk kanë mundur ta parashihnin suksesin e saj dhe rëndësinë e vendimit që mori ajo: përqafimin e plotë të drejtshkrimit të gjuhës shqipe që ishte në përdorim në shtetin amë, në Republikën e Shqipërisë, nga shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, sipas parimit: "Një komb - një gjuhë letrare", që u bë moto e kësaj konsulte. Nga perspektiva e sotme mund të thuhet se organizatorët e Konsultës, Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe e Fakultetit Filozofik, ndoshta nuk kishin mundur ta parashihnin plotësisht fundin e tubimit, rezultatin dhe përfundimet e tij, por kishin ditur ta zgjidhnin kohën e mbajtjes së tij: vitin 1968, që mund të quhet lirisht vit i Rilindjes Kombëtare të shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Le të na lejohet të themi se po t'i kishte zënë shqiptarët këndej kufirit viti 1981 në gjendjen gjuhësore të para '68-s, pra me variantin e letrarishtes gege që zbatohet deri në mbajtjen e Konsultës, përkatësisht deri në Kongresin e Drejtshkrimit, zgjidhja e problemit të gjuhës letrare shqipe do të komplikohej dhe mbështetur edhe do të shtyhej për një kohë të paparaparë.

E mbajtur në një kontekst të përshtatshëm historik, në kohën e zgjerimit të të drejtave politike të shqiptarëve në ish-Jugosllavi dhe të ngritjes së ndërgjegjes kombëtare e të nivelit të tyre kulturor, Konsulta e Prishtinës e përgatiti terrenin për mbajtjen e Kongresit të Drejtshkrimit (1972) dhe krijoj premit për njësimin e plotë të gjuhës shqipe në nivel kombëtar. Po të mos ishte marrë vendimi që u mor në '68-n në Prishtinë: përvetësimi i normës letrare të shtetit amë (mbi bazën e Projektit të hartuar nga një grup ekspertësh në Tiranë) vështirë se do të mund të mbahej Kongresi i '72-shit, që kurorëzoi procesin historik të njësimit të gjuhës shqipe dhe të drejtshkrimit të saj, kurse vendimet e tij, pa pjesëmarrjen e gjuhëtarëve dhe të intelektualëve nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe diaspora (këtu kemi parasysh në radhë të parë studiuesit arbëreshë), nuk do të kishin karakter kombëtar, por vetëm shtetëror.

Në Prishtinë edhe më parë ishte vënë në rend të dites çështja e ortografisë së gjuhës shqipe (më 1952, 1957 dhe 1963) - të asaj gjuhe që përdorin në shkollat shqipe dhe, pjesërisht, edhe në jetën publike, shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, por vetëm pas vitit 1966 mund të thuhet se ishin krijuar kushtet që intelektualët shqiptarë t'i shprehnin pak a shumë lirisht pikëpamjet e tyre për problemin e gjuhës letrare shqipe dhe, rrjedhimisht, edhe të merrnin vendimet e duhura lidhur me këtë çështje me rëndësi jetike për zhvillimin e tyre kulturor, arsimor e shoqëror në përgjithësi.

Në rrethet intelektuale në Kosovë e Maqedoni nuk kishin munguar as më parë zërat që kishin kërkuar respektimin e parimit të "trungut të përbashkët" lidhur me problemin e gjuhës, por ata zëra ishin shuar nga oligarkia politike e kohës. Pjesëmarrësit e tribunës kushtuar ortografisë së gjuhës shqipe të vitit 1963, e kujtojnë ndërhyrjen brutale të një politikanit të Kosovës ndaj një diskutimi në këtë fryshtë të një profesori të atëhershëm të Normales së Prishtinës: "Po doni me na sjellë këtu gjuhën e Enver Hoxhës-a?!".

Pa kaluar shumë vjet nga ky kërcënëm, që kishte si synim frikësimin e inteligjencies shqiptare dhe zmbropsjen e saj nga terreni kombëtar, ndodhën ndryshimet që e bënë të mundur mbajtjen e Konsultës Gjuhësore të Prishtinës dhe marrjen e vendimit për aplikimin e gjuhës së përbashkët letrare shqipe, alias "letrarishtes", si thuhej atëbotë. Plenumi i ashtu-quajtur "i Brioneve", që u mbajt në verë të vitit 1966, dënoi politikën repressive që kishte zhvilluar ministri i punëve të brendshme të Jugosllavisë së atëhershme, Aleksandër Rankoviqi, veçanërisht dhunën sistematike ndaj shqiptarëve, të cilët pas këtij viti dhe posaçërisht nga viti 1968 e tahu do të marrin fryshtë më lirisht dhe do ta manifestojnë më shlirë qenien dhe

vetëdijen e tyre kombëtare, duke e zgjeruar dukshëm gamën e veprimtarive institucionale kulturore, arsimore dhe shkencore.

Kështu, vetëm gjatë vitit 1968 u zhvilluan tri ngjarje tejet të rëndësishme për afirmimin e identitetit kombëtar e kulturor të shqiptarëve në Jugosllavi: shënimi i 500-vjetorit të vdekjes së heroit kombëtar, Skënderbeut, që kulmoi me një simpozium të madh shkencor të mbajtur në Prishtinë në qershor të atij viti; shënimi i 60-vjetorit të Kongresit të Manastirit (në nëntor), me ç'rast në shtëpinë ku qe mbajtur kongresi në qytetin e Manastirit u vu një pllakë përkujtimore, si dhe Konsulta Gjuhësore, që u priu dy ngjarjeve të para dhe që është objekt i interesimit tonë në këtë rast.

Si student i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në Fakultetin Filozofik të Prishtinës (sot Fakulteti i Filologjisë), pra pikërisht në institucionin ku u mbajt Konsulta, kam pasur privilegjin ta ndjek atë gjatë tërë kohës. Edhe pse ka kaluar plot gjysmë shekulli nga ajo kohë, e kujtoj atmosferën e përgjithshme, entuziaste e konstruktive, që zotëronte në sallë dhe jashtë saj, por edhe shumë detaje nga puna dyditore e Konsultës.

Për hir të së vërtetës duhet thënë se jo të gjithë pjesëmarrësit e Konsultës mendonin njësoj për problemin e shtruar për diskutim; se jo të gjithë ishin entuziastë për *Rregullat e drejtshkrimit*, të botuara një vit më parë në Tiranë (1967), që ishin shkas i mbajtjes së saj dhe objekt i diskutimit, por shumica e diskutuesve i mbështesnin ato dhe kërkonin përvetësimin e plotë të tyre dhe pa humbur kohë, natyrisht me vërejtje për përsosje të mëtejshme shkencore.

Por tonin tubimit ia dhanë ata diskutues që mbështesnin idenë e unifikimit, të mbështetur edhe nga auditori në sallë, ndër të cilët më të zëshmit ishim sigurisht ne studentët, që aprovonim fjalët e atyre që ishin “pro” dhe reagonim ndaj atyre që shfaqnin mospajtim me Projektin, aq sa në një rast njëri nga drejtuesit e mbledhjes, orientalisti Hasan Kaleshi, na u drejtua, ne “studentëve në galeri”, me vërejtjen që të mbanim qetësi.

Në arkivin tim personal ende e ruaj një bllok shënimesh, në të cilin kam mbajtur shënimë përrjedhën e punimeve të Konsultës - kësaj ngjarjeje të rëndësishme me karakter jo vetëm gjuhësor, por edhe kombëtar e kulturor, por “dëshminë” time për të, më shumë se në fletët e zverdhura të atij notesi studentor, e mbështes në kujtesë e evokime.

Më kujtohen fare mirë fjalët e dr. Petro Janurës, i cili, duke e marrë fjalën ndër të parët, pat dalë me kërkësen për “njësim të plotë” (“Jam për unifikim total!”, përsëri profesori nga Shkupi), si dhe diskutimi i mjekut të njobur kosovar, dr. Xheladin Deda, i cili, duke përdorur një term nga mjekësia, pat thënë se çështja e gjuhës sonë kishte nisur të bëhej “gangrenë”. E gangrena, pat shtuar mjeku i rrjer, kërkon ndërhyrje të menjëherëshme e të guximshme kirurgjike, në mënyrë që të mund të shpëtohet pjesa e shëndoshë e organizmit. Zërat e këtillë i bënин thirrje ndërgjegjes intelektuale që të mos hezitonte t'i dilte zot çështjes së gjuhës, si një nga faktorët kryesorë në zhvillimin e një kombi. Kjo frymë e pëershkonte edhe fjalën e shkurtër, por impresive, të historianit Ali Hadri me titull: “Një komb - një gjuhë letrare”,<sup>1</sup> e cila u bë në njëfarë dore moto e krejt konsultës.

Diskutimet si ai i Janurës, i dr. Dedës, i Ali Hadrit, i Xhevët Gegës e të tjera të ngjashme, e orientuan drejt punën e Konsultës dhe ia dhanë asaj tonin dhe kahjen e duhur.

Vlen të theksohet qëndrimi i drejtë që ka mbajtur inteligjencia shqiptare në Maqedoni ndaj problemit të gjuhët së përbashkët letrare. Gazeta “Flaka e vëllazërimit”, që dilte në Shkup, pat filluar t'i zbatonte *Rregullat e drejtshkrimit* të '67-s edhe para Konsultës së Prishtinës, ndërsa në një dokument të vitit 1959, hartuar nga një komision treanëtarësh i përbërë nga: Dr. Petro Janura, Murteza Peza dhe Krume Jakovski, ndër të tjera thuhej: “Ne propozojmë që edhe

<sup>1</sup> Shih: “Përparimi” (Prishtinë) nr. 3, 1968, f. 323-324.

shqiptarët në Jugosllavi ta përdorin një gjuhë letrare të përbashkët, atë që përdoret në Shqipëri”.<sup>2</sup>

Vendimet e Konsultës Gjuhësore të Prishtinës, konkluzat e saj, i mbështetën jo vetëm gjuhëtarët shqiptarë të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, por edhe intelektualët e profileve të tjera, si: studiuesit e letërsisë, shkrimtarët, publicistët, gazetarët, studentët, mësuesit, arsimtarët, lektorët, pedagogët e, madje, edhe njerëzit e thjeshtë e të pashkollë, gjë që ta kujton atë thënien e njohur se çështja e gjuhës nuk u përket vetëm gjuhëtarëve, por ajo është, siç thoshte Konica, çështje kombëtare e rendit të parë.

Menjëherë pas përfundimit të punimeve të Konsultës dhe miratimit të konkluzave të saj, filloi zbatimi i “letrarishtes”. Sipas rekomandimeve të Konsultës dhe konkluzave të saj, të miratuara njëzëri, filloj zbatimi i gjuhës së përbashkët letrare shqipe dhe i drejtshkrimit të saj në shkolla e në fakultete, në institucionet kulturore e shkencore, në veprimtarinë botuese dhe në tekstet shkollore, në mjetet e informimit publik, kurse pa kaluar shumë kohë nga mbajtja e saj, brenda vitit 1968, u botuan edhe veprat e para letrare, fillimisht në poezi e pastaj edhe prozë, në gjuhën e njësuar letrare.

Ndër oratorët e shumtë që gjatë atyre dy ditëve dolën në tribunën e Fakultetit Filozofik, ishte edhe një koleg yni student, i cili, duke mbështetur fuqimisht qëndrimin *pro* “Rregullave të drejtshkrimit” dhe politikën e atrimit gjuhësor, kulturor e shpirtëror në relacionin Kosovë-Shqipëri, ndër të tjera pat thënë: “Prej nesër revista jonë, revista e të rinjve të Kosovës, ‘Zani i rinisë’ të bëhet ‘Zëri i rinisë’”! Ky gjest i thjeshtë i kolegut tonë kishte sigurisht një kuptim simbolik. Ishte zëri i studentëve dhe të rinjve të Kosovës, zëri i brezit të ri, të brumosur me idealin e lirisë e të barazisë, i cili, pak muaj më vonë, në nëntor të atij viti, do të demonstronte rrugëve të Prishtinës dhe të qyteteve të tjera të Kosovës për të kërkuar themelimin e Universitetit të Prishtinës, lejimin e përdorimit të flamurit kombëtar, përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe në institucionet shtetërore, pa harruar as kërkesën që në vitin 1981 do të dilte në plan të parë, atë për avancimin e statusit politik të Kosovës në shkallë të Republikës, që shumë e shumë vjet më vonë, me shumë përpjekje e sakrifica, do të bëhet realitet.

Prishtina e '68-s dhe e viteve që do të pasojnë, ku po krijohej një inteligjencie e re me vizion të quartë historik dhe me formim të lartë shkencor, po dëshmohej përditë e më shumë jo vetëm si qendër e rëndësishme e studimeve albanologjike, por edhe si faktor me rëndësi në formësimin e kulturës kombëtare dhe të vetëdijes kombëtare në përgjithësi.

\*

Sot, pesëdhjetë vjet pas Konsultës Gjuhësore të Prishtinës (1968) dhe 45 vjet pas Kongresit të Drejtshkrimit (Tiranë, 1972), gjuha letrare shqipe ka bërë hapa të mëdhenj përpara, por është vënë njëkohësisht para sfidash të reja, siç janë, fjala vjen, përpjekja për ta kontestuar atë nga grupe e individë të ndryshëm me pretekstin se njësimi i saj është bërë në kushtet e një sistemi jodemokratik; moszbatimi dhe mosrespektimi i saj i pjesshëm apo edhe i plotë nga media të ndryshme të shkruara a elektronike apo edhe dukuri të tjera të ngjashme, që, me a pa dashje, e zhvleftësojnë dhe e degradojnë atë. Tendencat e tillë i kthejnë shqiptarët në fazën kur të tjerët, në projektet e tyre antishqiptare, nëpërmjet krijimit të dy gjuhëve letrare shqipe me emërtime përkatëse, përpinqeshin të krijonin dy popuj nga një komb i vetëm.

Askush nuk e mohon nevojën që gjuha standarde shqipe në kushtet e globalizmit si proces botëror dhe të revolucionit teknik e shkencor të jetë më fleksibile ndaj kërkesave që shtron

<sup>2</sup> Rezumeja e të tij dokumenti të gjerë prej 63 faqesh, të hartuar duket për nevojat e organeve partiake e shtetërore të Republikës së Maqedonisë dhe me kërkesën e tyre, u publiku në të përditshmen “Koha” të Shkupit më 14 gusht 2017 në dy faqe gazete.

koha para saj si organizëm i gjallë dhe më e hapur ndaj nënsistemeve, dialekteve e të folmeve, sikurse edhe ndaj stileve funksionale, por të kërkosh rishikimin e vendimeve të Kongresit të Drejtshkrimit dhe zhbërjen e gjuhës standarde shqipe është diçka thellësisht e gabuar, joshkencore dhe, madje, edhe antikombëtare.

Askush, nga ana tjetër, që për problemet e mëdha, siç është ai i gjuhës unike të një kombi, mendon drejt dhe pa paragjykime e keqdashje, nuk mund ta mohojë faktin se gjuha letrare/standarde shqipe në periudhën pas Konsultës Gjuhësore të Prishtinës, e cila, realisht, i parapriu Kongresit të Drejtshkrimit, me gjithë vështirësitë që ka hasur dhe vazhdon të hasë edhe sot, në nivele të ndryshme, ka bërë hapa të mëdhenj përpara dhe është bërë një faktor jashtëzakonisht i rëndësishëm i zhvillimit kulturor të shqiptarëve si komb dhe i integrimit të tyre shpirtëror.

Në kohën kur u mbajt Konsulta Gjuhësore, Kosova nuk ishte as përafërsisht në këtë shkallë të zhvillimit të saj që është sot, por inteligjencia shqiptare ishte më unike në mbrojtje të vlerave shpirtërore që e afrojnë Kosovën dhe shqiptarët me “shtetin amë”, Shqipërinë, në mesin e të cilave gjuha dhe në mënyrë të veçantë gjuha letrare standarde zë vendin e parë dhe kryesor.

Shikuar nga ky aspekt Konsulta Gjuhësore e '68-s na ofron një mesazh të madh e aktual sot e gjithë ditën.